REPUBLIKA E SHQIPERISË

Nr. 754/3 prot.

**PREFEKTI I QARKUT SHKODER**

Shkodër, më18.11.2024

**LËNDA: Mbi vendimin Nr.77 datë 30.10.2024 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.**

**KESHILLIT BASHKIAK VAU-DEJES**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 "Për Prefektin" i ndryshuar, në mbështetje të nenit 54/ç/dh, neni 55/3, neni 64/c të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të Ministrit te Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së Brendshme "Për organzimin dhe funksionimin e Institucionit te Prefektit të Qarkut" si dhe aneksi 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", Kreu II, neni 4, ligjit Nr.9936 datë.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetorë në RSH" i ndryshuar, ligjit Nr.68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë.20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", VKB Vau-Dejës Nr.90 datë.21.12.2023 "Për miratimin e nivelit të pagave për funksionaret e zgjedhur dhe të emëruar, nëpunësit civile, dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau-Dejës" i ndryshuar, neni 157 i VKB Vau-Dejës Nr.23 date.24.04.2020 "Mbi miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Bashkise Vau-Dejes", VKB Vau-Dejës Nr.91 datë.21.12.2023"Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetorë afatmesëm përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau-Dejës", analizoi relacionin Nr.6682/2prot datë 14.11.2024 në përgjigje të shkresës se Prefektit Nr.754/1prot datë 11.11.2024 mbi VKB Vau-Dejës nr.77 datë 30.10.2024 Mbi ndryshimin e VKB Nr.91 datë 21.12.2023 "Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetorë afatmesëm përfundimtar 2024-2026 dhe numrin e punonjësve të Bashkisë Vau-Dejës", ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**

Adresa: "Rruga 28 Nëntori" Shkodër, Telefon/Faks 00355 2224 2705, e-mail: Prefekti.Shkoder@mb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 6682/1 Prot
dt. 13.11.2024

Nr.754/1prot. Shkodër, më 11.11.2024

**LËNDA: Kërkohet dokumentacion plotësues mbi vendimin Nr.77, datë 30.10.2024 të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës.**

**KËSHILLI BASHKIAK VAU-DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 "Për Prefektin", në mbështetje të nenit 54/ç/dh, neni 55/3, neni 64/c të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të Ministrit te Brendshëm Nr.175/2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit te Prefektit të Qarkut" si dhe aneksi 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", Kreu II, neni 4, ligjit Nr.9936 date.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar, ligjit Nr.68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9/2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", VKB Vau-Dejës Nr.91 datë 21.12.2023 *"Buxheti i vitit 2024 dhe programit buxhetorë afatmesëm përfundimtar 2024-2026..."*, dokumentacionit të dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Vau-Dejës Nr.6679prot, datë 4.11.2024, u analizua ***VKB Vau-Dejës Nr.77, datë 30.10.2024*** Mbi ndryshimin e VKB Nr.91, datë 21.12.2023 *"Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau-Dejës"*.

Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175/2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit te Prefektit të Qarkut" si dhe aneksi 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", Kreu II, neni 4, germa b/iii, për shqyrtim të mëtejshëm kërkohet një relacion i argumentuar ligjërisht dhe financiarisht nga drejtoria e financës për shtesën e punonjësve sipas akteve ligjore/nënligjore (shembull neni 7 i ligjit Nr.152/2015 "Për Mbrojtjen nga Zjarri), burimin e financimit për këto shtesa sipas VKB Nr.91, datë 21.12.2023 *"Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau-Dejës"*.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKTI**

**Majlinda ANGONI**

Adresa: "Rruga 28 Nëntori" Shkodër, Telefon/Faks 00355 2224 2705, e-mail: Prefekti-Shkoder@mb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA EKONOMIKE DHE E MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 6682/2 Prot.

Vau Dejes me 14 /11/2024

**Drejtuar: Prefekti i Qarkut Shkoder**

**Sekretaria, Keshilli Bashkiak Vau Dejes**

**Lenda: Relacion sqarues, ne pergjigje te Shkreses nr. 754/1 prot., Date 11/11/2024, Prefekti i Qarkut Shkoder**

Ne pergjigje te shkreses suaj nr. 754/1 prot. , date 11/11/2024, ku kerkohet relacion i argumentuar ligjerisht dhe financiarisht, mbi VKB nr. 77 date 30/10/2024, Ju sqarojme si meposhte vijon:

Sa i perket pikes a) te VKB-se:

a) Të miratojë ndryshimin e numrit të punonjësve për njësinë shpenzuese - Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi – Programi 03280, për vitin 2024, të ndara sipas tabelës 1, dhe lidhjes nr 1, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi

Në mbështetje të dizpozitave të normuara në kuadrin e Ligjit nr.152/2015,''Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin'; VKM-së nr.520, datë 25.07.2019, ''Për Miratimin e Rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin'', dhe në përmbushje të funksioneve ligjore që i akordohen Kryetarit të Bashkisë sipas Ligjit nr. 139/2015, ''Për Vetëqeverisjen Vendore'', i ndryshuar, dhe legjislacionin sektorial në fuqi, eshte propozuar rritja e kapaciteteve në burimet njerzore të strukturës së MZSH-së në një numër prej 35 punonjës, bazuar ne nenin 16, pika 5 e VKM Nr. 520, date 25.7.2019 "Per miratimin e rregullores per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin", i cili percakton se: "Stacioni i Sherbimit te MZSH-se ngrihet ne çdo bashki sipas standardit 1 (nje) zjarrfikes profesionist per 1500-2000 banore".
Duke pasur parasysh se numri i popullsise sipas te dhenave te gjendjes civile ne Bashkine Vau Dejes, me date 01 janar 2024, ka qene 52,520, eshte propozuar shtimi i numrit te personelit zjarrfikes me 5 (pese) vete, nga 30 punonjes ne 35 punonjes, sipas standarit 1(nje) zjarrefikes profesionit per çdo 1500 banore.

Sa ju perket pikes b) dhe,c) te VKB-se:

Adresa: Rruga" Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006,ëeb: ëëë.vaudejes.gov.al, e-mail: info@vaudejes.gov.al

Sa ju perket pikes b) dhe c) te VKB-se:

b) Të miratojë ndryshimin e numrit të punonjësve për njësinë shpenzuese – Arsimi parashkollor(edukatore/punonjës arsimorë/punonjes ne Qendrat Kulturore te Fëmijëve) – Programi 09120, për vitin 2024, të ndara sipas tabelës 1 dhe lidhjes nr 2, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi
c) Të miratojë ndryshimin e numrit të punonjësve për njësinë shpenzuese – Arsimi i mesëm i përgjithshëm– Programi 09230, për vitin 2024, të ndara sipas tabelës 1 dhe lidhjes nr 3, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi

Ligji nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", neni 28 percakton:
"Njësia bazë e qeverisjes vendore
1. Njësia bazë e qeverisjes vendore ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Kompetencat kryesore të njësisë bazë të qeverisjes vendore janë: a) ndërtimi dhe rikonstruksioni i godinave të institucioneve arsimore publike, sipas standardeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me fonde të Buxhetit të Shtetit ose me fonde nga transferta e pakushtëzuar ose të ardhurat e veta;
b) garantimi i paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe i mjediseve të tyre;
c) ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik;
ç) garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike. "

Konsideruar qe struktura aktuale e Bashkisë Vau Dejës, ka të miratuara 22 Sanitare, 9 Punonjës Mirëmbajtje dhe 5 Roje Shkolle, nderkohe qe Bashkia Vau Dejës ka 5 Shkolla të Mesme,10 Shkolla 9-vjecare dhe 20 Kopshte, propozimi per rritjen e kapaciteteve në burimet njerëzore, të strukturës së Shërbimeve Publike me një numër prej 10 (dhjetë) personash; të ndarë në 5 (pesë) Roje Shkolle dhe 5 (pesë) Sanitare Shkolle është bërë në përputhje me percatimet ligjore te cituara mesiper.

Shtesat e pozicioneve te punes te permendura ne pikat a), b) c) mesiper, dhe sipas VKB nr. 77 date 30.10.2024, kane efekte financiare ne llogarite ekonomike 6000000(paga) dhe 6010000(sigurime shoqerore dhe shendetsore), te perllogaritura per vitin 2024 ne total ne vleren 1.363.200 lek ( periudha 15 Nentor-31 Dhjetor 2024), respektivisht 627.990 lek pika a), 367.605 lek pika b) dhe 367.605 lek pika c).

Ne buxhetin e vitit 2024, bashkia ka parashikuar shpenzime ne llogarite ekonomike 6000000(paga) dhe 6010000(sigurime shoqerore dhe shendetsore) si vijon:

| | Programi 03280 | Burimi i financimit | Programi 09120 | Burimi i financimit | Programi 09230 | Burimi i financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Llog. Ekonomike 6000000 | 22,814,880 | TPK+TS | 57,503,760 | TPK+TA+TS | 13,577,040 | TPK+TA+TS |
| Llog. Ekonomike 6010000 | 3,821,492 | TPK+TS | 9,631,880 | TPK+TA+TS | 2,274,154 | TPK+TA+TS |
| **Total** | **26,636,372** | | **67,135,640** | **(TA 2,606,638)** | **15,851,194** | **(TA 1,291,601)** |

*TPK=transferte e pa kushtezuar*
*TS=transferte sektoriale*
*TA= te ardhura bashkia*

Nga analiza e shpenzimeve per llogarite ekonomike 6000000(paga) dhe 6010000(sigurime shoqerore dhe shendetsore), per programet e interesuara nga ky VKB, periudha 01/01/2024-31/10/2024, fakti, dhe 01/11/2024-31/12/2024 projeksion, rezulton si vijon:

| | Pag bruto + Sigurime (16.7%) | Pag bruto + Sigurime (16.7%) | Pag bruto + Sigurime (16.7%) |
|---|---|---|---|
| | Programi 03280 | Programi 09120 | Programi 09230 |
| Janar | 1,400,402 | 5,192,544 | 1,027,641 |
| Shkurt | 1,402,377 | 5,190,582 | 1,075,623 |
| Mars | 1,686,495 | 5,179,518 | 1,075,623 |
| Prill | 1,834,536 | 5,190,937 | 1,074,150 |
| Maj | 1,859,391 | 5,253,606 | 1,075,623 |
| Qershor | 1,904,054 | 5,161,159 | 1,073,953 |
| Korrik | 1,808,656 | 5,248,279 | 1,063,245 |
| Gusht | 2,724,872 | 6,309,102 | 1,183,284 |
| Shtator | 3,399,449 | 5,879,326 | 1,136,442 |
| Tetor | 2,439,269 | 5,936,947 | 1,038,487 |
| Nëntor | 2,439,269 | 5,936,947 | 1,048,843 |
| Dhjetor | 2,439,269 | 5,936,947 | 1,048,843 |
| | | | |
| Fakt+projeksion (600+601) | **25,338,039** | **66,415,894** | **12,921,757** |
| | | | |
| Buxheti 600+601 | 26,636,372 | 67,135,640 | 15,851,194 |
| | | | |
| **Diferenca** | **1,298,333** | **719,746** | **2,929,437** |

- vlerat e buxhetuara per secilin nga programet jane me te larta se vlerat e e shpenzuara, dhe si rrjedhoje ka teprica qe lejojne perballimin e shpenzimeve shtese qe vijojne nga efektet financiare te VKB nr. 77 date 30/10/2024.
- pagesat e kryera gjate vitit, deri me tani, jane realizuar duke perdorur burimin e financimit TPK dhe TS, si rrjedhoje per likuidimin e shumave qe vijojne nga VKB objekt i ketij relacioni do te mund te perdoren Te Ardhurat e Bashkise, per Programin 09120 dhe Programin 09230, ndersa per programin Programi 03280 do te perdoret TPK.

KRYETAR

Kristian SHKRELI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Drejtoria Juridike e Integrimit Prokurimeve dhe Aseteve

Drejtoria e Burimeve Njerëzore

P/BNJ Ermira Jeri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**

**KESHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 77, datë 30.10.2024**

**"PËR NDRYSHIMIN E VKB NR 91 DATË 21.12.2023 "MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2024 – 2026, NUMRIN E PUNONJËSVE TË BASHKISË VAU DEJËS".**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 30.10.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9, nenet 34-37, 40, 41, *54 shkronja "dh"*, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të,ndryshuar;, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit te buxhetit', Ligji 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", VKB nr 90 datë 21.12.2023 'Për miratimine e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar, nënpunësit civil, dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024" *i ndryshuar*, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 1/1 prot datë 12.01.2024, VKB nr 91 datë 21.12.2023 "Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2024 – 2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 2/1 prot datë 09.01.2024, Udhëzimit Plotësues nr 1 datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", *Sipas Urdhërit të Kryetarit nr 581 datë 17.09.2024 "Për miratimin e strukturës organizative, organigramën, kategoritë dhe klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe administrativ për vitin buxhetor 2024", relacionit të Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Zhvillimit të Turizmit, dhe relacionit shpjegues të Shefit të Sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, dhe shkresës nr 148 prot, datë 16.09.2024 "Dërgim dokumentacioni", nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve mbështetëse – Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:*

**V E N D O S I:**

**1.**Të miratojë ndryshmin e numrit të punonjësve, të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:

**a)**Të miratojë ndryshimin e numrit të punonjësve për njësinë shpenzuese - Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi – Programi 03280, për vitin 2024, të ndara sipas tabelës 1, dhe lidhjes nr 1, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi
**b)**Të miratojë ndryshimin e numrit të punonjësve për njësinë shpenzuese – Arsimi parashkollor(edukatore/punonjës arsimorë/punonjes ne Qendrat Kulturore te Fëmijëve) – Programi 09120, për vitin 2024, të ndara sipas tabelës 1 dhe lidhjes nr 2, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi
**c)**Të miratojë ndryshimin e numrit të punonjësve për njësinë shpenzuese – Arsimi i mesëm i përgjithshëm– Programi 09230, për vitin 2024, të ndara sipas tabelës 1 dhe lidhjes nr 3, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi

**2.**Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

**3** Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 date 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"(i ndryshuar)

**SEKRETAR**

Ardian **ÇELEPIJA**

**KRYETAR**

Ervis **SHIMAJ**

Miratuar me 20 vota
Vota pro 18
Vota kunder 1 (një)
Vota abstenim 1 (një)
Zbardhur me datë 04 /11 /2024

**INSTITUCIONI :BASHKIA VAU-DEJËS**

**Tabela 1: Numri i punonjësve**
**Njesia e Veteqeverisjes Vendore: Bashkia Vau Dejes**

ISHTE

| | | | | | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Emertimi i programit** | **Programet** | **Kodi i institucionit** | **Kohe e punuar mesatarisht per punonjes me kontrate** | **Numri i parashikuar i punonjesve** | **Numri i parashikuar i punonjesve** | **Numri i parashikuar i punonjesve** |
| 1 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 01110 | 2157001 | | 158 | 154 | 155 |
| | **Total 01** | | | | **158** | **154** | **155** |
| 2 | Shërbimet e Policisë Vendore | 03140 | 2157001 | | 15 | 13 | 13 |
| 3 | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | 03280 | 2157001 | | **30** | 25 | 23 |
| | **Total 03** | | | | **45** | **38** | **36** |
| 4 | Mbeshtetje e zhvillimit ekonomik | 04130 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| | **total 041** | | | | **0** | **0** | **0** |
| 5 | Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve | 04220 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit | 04240 | 2157001 | | 20 | 17 | 16 |
| 7 | Administrimi i pyjeve dhe kullotave | 04260 | 2157001 | | 17 | 12 | 12 |
| | **Total 042** | | | | **37** | **29** | **28** |
| 8 | Rrjeti rrugor rural | 04520 | 2157001 | | 11 | 11 | 11 |
| | **Total 045** | | | | **11** | **11** | **11** |
| 9 | Planifikimi urban vendor | 06140 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| 10 | Sherbimet Publike Vendore | 06260 | 2157001 | | 50 | 46 | 45 |
| | **Total 06** | | | | **50** | **46** | **45** |
| 11 | Sport dhe argëtim | 08130 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| 12 | Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat | 08220 | 2157001 | | 9 | 9 | 9 |
| | **Total 08** | | | | **9** | **9** | **9** |
| 13 | Arsimi parashkollor përfshirë arsimin bazë | 09120 | 2157001 | | 72 | 72 | 72 |
| 14 | Arsimi i mesëm i përgjithshëm | 09230 | 2157001 | | 6 | 6 | 6 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | Konvikti | 09230 | 2157001 | | 16 | 16 | 16 |
| | **Total 09** | | | | **94** | **94** | **94** |
| 16 | Përkujdesja Sociale | 10430 | 2157001 | | 18 | 18 | 18 |
| | **Total 104** | | | | **18** | **18** | **18** |
| | **TOTAL** | | | | **422** | **399** | **396** |

**BEHET**

| Nr | Emertimi i programit | Programet | Kodi i institucionit | Kohe e punuar mesatarisht per punonjes me kontrate | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Numri i parashikuar i punonjesve | Numri i parashikuar i punonjesve | Numri i parashikuar i punonjesve |
| 1 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 01110 | 2157001 | | 158 | 154 | 155 |
| | **Total 01** | | | | **158** | **154** | **155** |
| 2 | Shërbimet e Policisë Vendore | 03140 | 2157001 | | 15 | 13 | 13 |
| 3 | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | 03280 | 2157001 | | **35** | 25 | 23 |
| | **Total 03** | | | | **50** | **38** | **36** |
| 4 | Mbeshtetje e zhvillimit ekonomik | 04130 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| | **total 041** | | | | **0** | **0** | **0** |
| 5 | Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve | 04220 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit | 04240 | 2157001 | | 20 | 17 | 16 |
| 7 | Administrimi i pyjeve dhe kullotave | 04260 | 2157001 | | 17 | 12 | 12 |
| | **Total 042** | | | | **37** | **29** | **28** |
| 8 | Rrjeti rrugor rural | 04520 | 2157001 | | 11 | 11 | 11 |
| | **Total 045** | | | | **11** | **11** | **11** |
| 9 | Planifikimi urban vendor | 06140 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| 10 | Sherbimet Publike Vendore | 06260 | 2157001 | | 50 | 46 | 45 |
| | **Total 06** | | | | **50** | **46** | **45** |
| 11 | Sport dhe argëtim | 08130 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| 12 | Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat | 08220 | 2157001 | | 9 | 9 | 9 |
| | **Total 08** | | | | **9** | **9** | **9** |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | Arsimi parashkollor përfshirë arsimin bazë | 09120 | 2157001 | | **77** | 72 | 72 |
| 14 | Arsimi i mesëm i përgjithshëm | 09230 | 2157001 | | **11** | 6 | 6 |
| 15 | Konvikti | 09230 | 2157001 | | 16 | 16 | 16 |
| | **Total 09** | | | | **104** | **94** | **94** |
| 16 | Përkujdesja Sociale | 10430 | 2157001 | | 18 | 18 | 18 |
| | **Total 104** | | | | **18** | **18** | **18** |
| | **TOTAL** | | | | **437** | **399** | **396** |

**Kryetari Këshillit**

**Ervis Shimaj**

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA VAU I DEJËS

**Sekretari Këshillit**

**Ardian Çelepija**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA VAU DEJËS**
**KRYETAR**

---

**PROJEKT-VENDIM**

**Nr.__11__, datë_26_._09_.2024**

**"PËR**

**NDRYSHIMIN E VKB NR 91 DATË 21.12.2023 "MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2024 – 2026, NUMRIN E PUNONJËSVE TË BASHKISË VAU DEJËS".**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës_____.____.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9, nenet 34-37, 40, 41, *54 shkronja "dh"*, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të,ndryshuar;, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit te buxhetit', Ligji 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", VKB nr 90 datë 21.12.2023 'Për miratimine e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar, nënpunësit civil, dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024" *i ndryshuar*, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 1/1 prot datë 12.01.2024, VKB nr 91 datë 21.12.2023 "Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2024 – 2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 2/1 prot datë 09.01.2024, Udhëzimit Plotësues nr 1 datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", *Sipas Urdhërit të Kryetarit nr 581 datë 17.09.2024 "Për miratimin e strukturës organizative, organigramën, kategoritë dhe klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe administrativ për vitin buxhetor 2024", relacionit të Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Zhvillimit të Turizmit, dhe relacionit shpjegues të Shefit të Sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, dhe shkresës nr 148 prot, datë 16.09.2024 "Dërgim dokumentacioni", nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve mbështetëse – Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:*

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë ndryshimin e numrit të punonjësve, të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:

   a) Të miratojë ndryshimin e numrit të punonjësve për njësinë shpenzuese - Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi – Programi 03280, për vitin 2024, të ndara sipas tabelës 1, dhe lidhjes nr 1, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi

---

Adresa: Rruga" Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006,ëeb: ëëë.vaudejes.gov.al, e-mail: info@vaudejes.gov.al

b) Të miratojë ndryshimin e numrit të punonjësve për njësinë shpenzuese – Arsimi parashkollor(edukatore/punonjës arsimorë/punonjes ne Qendrat Kulturore te Fëmijëve) – Programi 09120, për vitin 2024, të ndara sipas tabelës 1 dhe lidhjes nr 2, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi
c) Të miratojë ndryshimin e numrit të punonjësve për njësinë shpenzuese – Arsimi i mesëm i përgjithshëm– Programi 09230, për vitin 2024, të ndara sipas tabelës 1 dhe lidhjes nr 3, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Kristian SHKRELI**

*Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar*

______________________________

*Drejtoria Juridike e Integrimit Prokurimeve dhe Aseteve*

______________________________

*Drejtoria e Burimeve Njerëzore*

______________________________

*Drejtoria e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile*

______________________________

*Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit*

______________________________

INSTITUCIONI :BASHKIA VAU-DEJËS

**Tabela 1: Numri i punonjësve**
**Njesia e Veteqeverisjes Vendore: Bashkia Vau Dejes**

## ISHTE

| Nr | Emertimi i programit | Programet | Kodi i institucionit | Kohe e punuar mesatarisht per punonjes me kontrate | 2024<br>Numri i parashikuar i punonjesve | 2025<br>Numri i parashikuar i punonjesve | 2026<br>Numri i parashikuar i punonjesve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 01110 | 2157001 | | 158 | 154 | 155 |
| | **Total 01** | | | | **158** | **154** | **155** |
| 2 | Shërbimet e Policisë Vendore | 03140 | 2157001 | | 15 | 13 | 13 |
| 3 | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | 03280 | 2157001 | | 30 | 25 | 23 |
| | **Total 03** | | | | **45** | **38** | **36** |
| 4 | Mbeshtetje e zhvillimit ekonomik | 04130 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| | **total 041** | | | | **0** | **0** | **0** |
| 5 | Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve | 04220 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit | 04240 | 2157001 | | 20 | 17 | 16 |
| 7 | Administrimi i pyjeve dhe kullotave | 04260 | 2157001 | | 17 | 12 | 12 |
| | **Total 042** | | | | **37** | **29** | **28** |
| 8 | Rrjeti rrugor rural | 04520 | 2157001 | | 11 | 11 | 11 |
| | **Total 045** | | | | **11** | **11** | **11** |
| 9 | Planifikimi urban vendor | 06140 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| 10 | Sherbimet Publike Vendore | 06260 | 2157001 | | 50 | 46 | 45 |
| | **Total 06** | | | | **50** | **46** | **45** |
| 11 | Sport dhe argëtim | 08130 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| 12 | Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat | 08220 | 2157001 | | 9 | 9 | 9 |
| | **Total 08** | | | | **9** | **9** | **9** |
| 13 | Arsimi parashkollor përfshirë arsimin bazë | 09120 | 2157001 | | 72 | 72 | 72 |
| 14 | Arsimi i mesëm i përgjithshëm | 09230 | 2157001 | | 6 | 6 | 6 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | Konvikti | 09230 | 2157001 | | 16 | 16 | 16 |
| | **Total 09** | | | | **94** | **94** | **94** |
| 16 | Përkujdesja Sociale | 10430 | 2157001 | | 18 | 18 | 18 |
| | **Total 104** | | | | **18** | **18** | **18** |
| | **TOTAL** | | | | **422** | **399** | **396** |

**BEHET**

| | | | | | **2024** | **2025** | **2026** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Emertimi i programit** | **Programet** | **Kodi i institucionit** | **Kohe e punuar mesatarisht per punonjes me kontrate** | **Numri i parashikuar i punonjesve** | **Numri i parashikuar i punonjesve** | **Numri i parashikuar i punonjesve** |
| 1 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 01110 | 2157001 | | 158 | 154 | 155 |
| | **Total 01** | | | | **158** | **154** | **155** |
| 2 | Shërbimet e Policisë Vendore | 03140 | 2157001 | | 15 | 13 | 13 |
| 3 | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | 03280 | 2157001 | | **35** | 25 | 23 |
| | **Total 03** | | | | **50** | **38** | **36** |
| 4 | Mbeshtetje e zhvillimit ekonomik | 04130 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| | **total 041** | | | | **0** | **0** | **0** |
| 5 | Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve | 04220 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit | 04240 | 2157001 | | 20 | 17 | 16 |
| 7 | Administrimi i pyjeve dhe kullotave | 04260 | 2157001 | | 17 | 12 | 12 |
| | **Total 042** | | | | **37** | **29** | **28** |
| 8 | Rrjeti rrugor rural | 04520 | 2157001 | | 11 | 11 | 11 |
| | **Total 045** | | | | **11** | **11** | **11** |
| 9 | Planifikimi urban vendor | 06140 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| 10 | Sherbimet Publike Vendore | 06260 | 2157001 | | 50 | 46 | 45 |
| | **Total 06** | | | | **50** | **46** | **45** |
| 11 | Sport dhe argëtim | 08130 | 2157001 | | 0 | 0 | 0 |
| 12 | Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat | 08220 | 2157001 | | 9 | 9 | 9 |
| | **Total 08** | | | | **9** | **9** | **9** |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | Arsimi parashkollor përfshirë arsimin bazë | 09120 | 2157001 | | **77** | 72 | 72 |
| 14 | Arsimi i mesëm i përgjithshëm | 09230 | 2157001 | | **11** | 6 | 6 |
| 15 | Konvikti | 09230 | 2157001 | | 16 | 16 | 16 |
| | **Total 09** | | | | **104** | **94** | **94** |
| 16 | Përkujdesja Sociale | 10430 | 2157001 | | 18 | 18 | 18 |
| | **Total 104** | | | | **18** | **18** | **18** |
| | TOTAL | | | | 437 | 399 | 396 |

**Nëpunës Zbatues**

**Elsa Tanushi**

**Nëpunës Autorizues**

**Kristian Shkreli**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

**Lidhja nr.3 "Struktura dhe numëri i punonjësve të arsimi të mesëm punonjës mbështetës"**

VKM nr 326 datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike".

| | | | | | Niveli Arsimor |
|---|---|---|---|---|---|
| Emërtimi | Punonjës | | Lidhja/Klasa | Paga | I mesem/9 vjecar |
| Roje | 1 | | Lidhja II/I | 40000 | |
| Roje | 1 | | Lidhja II/I | 40000 | |
| Roje | 1 | | Lidhja II/I | 40000 | |
| Sanitare | 1 | | Lidhja II/I | 40000 | |
| Roje Shkolle | 1 | | Lidhja II/I | 40000 | |
| Roje Shkolle | 1 | | Lidhja II/I | 40000 | |
| **Roje Shkolle** | 1 | | Lidhja II/I | 40000 | |
| **Roje Shkolle** | 1 | | Lidhja II/I | 40000 | |
| **Roje Shkolle** | 1 | | Lidhja II/I | 40000 | |
| **Roje Shkolle** | 1 | | Lidhja II/I | 40000 | |
| **Roje Shkolle** | 1 | | Lidhja II/I | 40000 | |
| **Totali punonjes** | **11** | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**
**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**Nr** 148 **prot**

**Vau Dejës, me** 16.09 **2024**

**Lënda:** Dërgim dokumentacioni

**Z. RENADO DODA**

**PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË BUXHETIT DHE FINANCËS**

**I nderuar,**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Relacionin Nr. 145, datë 10.09.2024 të Drejtorit të Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Zhvillimit të Turizmit, Z. Devis Peci, dhe Relacionin Shpjegues Nr. 146, datë 10.09.2024 të Shefit të Sektorit të MZSH, Z. Leonard Dodani.

***Faleminderit.***

**PËRGJEGJËSE E BNJ**
**Ermira Jeri**

Adresa: Rruga" Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006,web: www.vaudejes.gov.al, e-mail: info@vaudejes.gov.al

Nr.145 Prot, dt. 10.09.2024
P/BNJ Ermira Jeri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**

**DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE, ARSIMIT, RINISË, SPORTIT DHE ZHVILLIMIT TË TURIZMIT**

**Vau Dejës, me 10.09.2024**

**Lënda:** **Relacion**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**Z. Kristian Shkreli**

**PËRGJEGJËSIT TË BURIMEVE NJERËZORE**
**Znj. Ermira Jeri**

**Të nderuar,**
Në mbështetje të Ligjit Nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kërkojmë nga ana juaj të propozoni rritjen e kapaciteteve në burimet njerëzore, të strukturës së Shërbimeve Publike me një numër prej 10 (dhjetë) personash; të ndarë në 5 (pesë) Roje Shkolle dhe 5 (pesë) Sanitare Shkolle; duke ndjekur arsyetimin si më poshtë:

- Struktura aktuale e Bashkisë Vau Dejës, ka të miratuara 22 Sanitare, 9 Punonjës Mirëmbajtje dhe 5 Roje Shkolle, numër i cili e ka të pamundur të mbulojë shërbimet në shkolla që duhet të ofrojë Bashkia me kapacitete njerëzore.

- Bashkia Vau Dejës ka 5 Shkolla të Mesme,10 Shkolla 9-vjecare dhe 20 Kopshte . Kjo ka bërë që shërbimet i kanë kryer edhe punonjës të tjerë të Shërbimeve Publike.

Kjo kërkesë është bërë në përputhje me nevojat e shkollave ne Bashkinë Vau Dejës ku struktura aktuale nuk përmbushë nevojat për mirëmbajtjen dhe sigurinë e institucioneve arsimore . Për shkak të personelit , disa shkolla janë lënë pa kujdesin e duhur dhe mbulimi i shërbimeve është vështirësuar.

**Nevojat për Shtimin e Personelit:**
Aktualisht , në bashkinë Vau Dejës ka 22 sanitare dhe vetën 9 punonjës për mirëmbajtje dhe 5 roje shkollash . Këto nuk janë të mjaftueshëm për të mbuluar nevojat e shkollave që janë të shpërndara në zona të ndryshme , përfshirë shkollat 9- vjeçare , shkollat e mesme dhe kopshtet.

**Pasojat e Mungesës së Personelit:**

1. Higjena dhe shëndeti publik:

Pa një numër të mjaftueshëm të sanitareve , mirëmbajtja e pastërtisë në shkolla është e pamundur të kryhet në nivelin e duhur. Kjo krijon një ambjent të pasigurt për nxënësin dhe stafin.

2. Siguria e nxënësve :

Mungesa e rojeve në shkolla e bën të vështirë sigurimin e godinave . Rojet e shkollave janë të domosdoshëm për të monitoruar hyrjet dhe daljet e paligjshme ,duke garantuar sigurinë e nxënësve dhe të stafit arsimor.

3. Mbarëvajtja e Procesit Mësimor:

Shërbimet e mirëmbajtjes luajnë një rol të rëndësishëm në funksionimin e rregullt të shkollave.
Pa një numër të mjaftueshëm të punonjësve mirëmbajtjeje , infrastruktura shkollore rrezikon degradim , duke krijuar problem që ndikojnë në mësimdhënie.

Propozimi ynë është të shtojmë të paktën 10 pozicione të reja në structures e Shërbimeve Publike, duke ndarë këto vende pune në 5 roje të shkollave dhe 5 sanitare. Ky shtim do të garantonte që çdo shkollë të ketë stafin e duhur për të ruajtur higjenën dhe sigurinë e nxënësve dhe stafit.

**DREJTORI**
**Devis Peci**

**Konceptoi:**
Melita Vjerdha (P/Sektorit të Arsimit)

Nr. 146, dt. 10.09.20
PIBNJ, Ermina Je

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**

**SEKTORI I SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN**

**Nr** 05 **prot**

**Vau Dejës, me** 10 . 09 **2024**

## RELACION SHPJEGUES

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**Z. Kristian Shkreli**

Në mbështetje të dizpozitave të normuara në kuadrin e Ligjit nr.152/2015,''Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin'; VKM-së nr.502, datë 25.07.2019, ''Për Miratimin e Rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin'', dhe në përmbushje të funksioneve ligjore që i akordohen Kryetarit të Bashkisë sipas Ligjit nr. 139/2015, ''Për Vetëqeverisjen Vendore'', i ndryshuar, dhe legjislacionin sektorial në fuqi, kërkojmë nga ana juaj të propozoni rritjen e kapaciteteve në burimet njerzore të strukturës së MZSH-së në një numër prej 35 punonjësish, duke ndjekur arsyetimin si në vijim:

Njësia Administrative Vig-Nnelë ka një territor të shtrirë deri në kufi me qytetin e Lezhës, e cila ka një sipërfaqe të madhe me pyje pishe dhe lisi, në të cilën ndërhyrja për shuarjen e zjarreve bëhet vetëm me mjete rrethanore dhe pompa shpine, në mungesë të rrugës për kalimin e automjeteve zjarrfikës.

Gjithashtu, infrastruktura rrugore që karakterizon Njësinë Administrative Shllak është mjaft e dobët, meqë territory është shumë i thyer malor, ku problematikat janë njësoj si në Nj. A. Vig-Mnelë.

Edhe Njësia Administrative Temal ka një territor mjaft të thyer dhe të shtrirë, duke u kufizuar me Tropojën. Në këtë njësi Administrative nuk kemi rrugë automibilistike që ndërhyrjet për shuarjen e zjarrit të bëhen me automjete zjarrfikëse. Për këtë arsye, jemi të detyruar që në të gjitha vatrat e zjarrit të bëhen shuarja e zjarrit me forca zjarrfikëse, me mjete rrethanore, dhe pompa shpine.

Përveq kësaj, në këtë njësi kemi lëvizje të shumta turistësh në Portin e Komanit në drejtim të Lumit të Shalës, si dhe në Valbonë, nëpërmjet Liqenit të Komanit. Numri i turistëve varion nga 2500-3000 në ditë.

Përsa i përket Njësisë Administrative Shllak duhet të përshkosh rrugën nga Shkodra, pasi nuk kemi akses rrugor nga Bashkia jonë. Edhe në këtë njësi ngrihet e njëjta problematikë, si në njësitë e tjera.

Duke u nisur nga numri i madh i zjarreve që kemi pasur këtë vit në zonat malore, ku shpesh kemi kërkuar ndihmën e ushtrisë me forca njerëzore, për të përballuar situatat e zjarreve;

*Kërkojmë që të keni parasysh rritjen e kapaciteteve tona njerëzore, pasi e kemi të pamundur t'u përgjigjemi nevojave të situatave emergjente sipas kërkesave të përcaktuara nga legjislacioni për shërbimin zjarrfikës*, veçanërisht në këto njësi, ku ndërhyrja është e pamundur të realizohet normalisht, por kërkon nevojën e mjeteve të specializuar si; automjete zjarrëfikëse të përshtatshme për terren malor ose pompa shpine, duke e vështirësuar së tepërmi ofrimin cilësor dhe në kohë reale të shërbimit në këto zona.

**SHEF SEKTORI I MZSH-SË**
**Leonard Dodani**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**
**KRYETARI**

Nr 5669 prot

Vau Dejës, me 17 . 09 . 2024

# URDHËR

**Nr 581 Datë 17 . 09 . 2024**

**PËR**

**MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIGRAMËN, KATEGORITË DHE KLASAT E PAGAVE PËR ÇDO POZICION TË SHËRBIMIT CIVIL DHE ADMINISTRATIV PËR VITIN BUXHETOR 2024.**

Bazuar në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1, germa c, nenin 64 germa j, e Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, në Ligjin nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 19 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në Ligjin nr.152/2015, "Për shërbimin e mbrotjes nga zjarri dhe shpëtimi", në VKM nr. 520, datë 25.07.2019, "Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrotjes nga zjarri dhe shpëtimi", në Vendimin nr. 419, datë 26.06.2024 "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punojësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në VKM nr. 503, datë 01.08.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime të VKM nr. 328 datë 31.5.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", në VKM nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", në VKM nr. 425, datë 26.06.2024, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar", në VKM nr. 421, datë 26.06.2024, "Për disa shtesa në VKM Nr.325, datë 31.05.2023, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave dhe disa shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, të nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike, i ndryshuar";

**URDHËROJ:**

- Miratimin e srukturës organizative, organigramën, kategoritë dhe klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe administrativ për vitin buxhetor 2024 *(sipas tabelave bashkëlidhur këtij urdhëri).*

- Urdhërohen punonjësit e sekretarisë dhe protokollit t'i kalojë për njohje Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, strukturën e re organizative, mbi të cilën Këshilli Bashkiak do të vendosë për numrin e përgjithshëm të punonjësve dhe nivelin maksimal të pagave për çdo klasë dhe kategori.

- Ngarkohet për zbatimin e ketij urdhëri Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Buxhetit dhe Financës.

***Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.***

**KRYETARI**
**Kristian Shkreli**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS